



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
NJËSIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

RELACION

Lezhë me 15.08.2023

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar Këshilltarë!

Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë vlerëson si të rëndësishme mundësitë potenciale për shfrytëzimin e asetëve pyje dhe kullota për alternativa të ndryshme përdorimi, me fokus zhvillimin e biznesit nga kompani të ndryshme të interesuara. Dhënia në përdorim e sipërfaqeve pyjore duhet parë si një interes financiar i Bashkisë pasi nga kryerja e këtyre transaksioneve gjenerohen të ardhura duke i perkthyer në investime për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kullësor Bashkiak. Sipas studimit të kryer nga Njësia e Administrimit të Pyjeve sipërfaqja e marrë në studim dhe që ju propozohet të jepet në përdorim sipas procedurave të prokurimit publik me garë të hapur, plotëson të gjitha kushtet duke filluar nga; pozita gjeografike, gjendja aktuale e territorit, kundrejtimi për vendosjen e Paneleve Diellore si një spërmarje e parashikuar në legjislacionin në fuqi. Pasi është përcaktuar sipërfaqja pyjore ku mund të vendosen Panelet Diellore, është hartuar raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore që do të preket nga projekti fitues, gjithashtu është nxjerrë edhe vlera financiare e përdorimit të sipërfaqes dhe të infrastrukturës ndihmëse. Interes për marrjen në përdorim të kësaj sipërfaqeje pyjore ka shprehur kompania GJONI KALIVAÇ Sh.p.k me adresë, Tresh, Zejmen, Lezhë, rruga Lezhë-Tiranë, ndërtesa 2 kat më numër pasurie 59/90 zona kadastrale 3641, por pas dhënies së dakortësisë nga ana juaj, procedura do ti nënshtrohet garës, sipas akteve ligjore për prokurimin publik.

Baza ligjore:

Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore".

Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

Ligji nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Ligji nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet".

VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".

VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore"

Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorirn të fondit pyjor dhe kullosor publik"

Duke pritur miratimin tuaj ju falenderojmë për mirëkuptimin!

Hartoi relacionin

Përgjegjësi i Njesisë së Administrimit të Pyjeve

Artan PALUSHI

